

Anketa Tremujore e Forcave të Punës

Tremujori II 2014

Tiranë, më 10 shtator 2014: Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2014, sipas Anketës së Forcave të Punës, numri i të punësuarve të moshës 15-64 vjeç është 1.006.307 persona. Numri i personave të papunë të moshës 15-64 vjeç është 216.087 persona.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2014 në Shqipëri:

- Për popullsinë e moshës 15-64 vjeç shkalla e papunësisë është 17,7 %.
- Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë është 33,5 %.
- 61,3 % e popullsisë 15-64 vjeç është aktive në tregun e punës, pra e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune.
- Shkalla e punësimit për popullsinë e moshës 15-64 vjeç është 50,5 %.

Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2013 për popullsinë 15-64 vjeç:

- Numri i të punësuarve është rritur me 15.869 persona.
- Numri i personave të papunë është rritur me 21.864.
- Numri i personave në moshë 15-64 vjeç jashtë tregut të punës ka rënë me 18.074.


Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014 për popullsinë 15-64 vjeç:

- Numri i të punësuarve është rritur me 70.707.
- Numri i personave të papunë është rritur me 1.719.
- Numri i personave në moshë 15-64 vjeç jashtë tregut të punës ka rënë me 66.874

Tab.1 Përmbledhje e treguesve të tregut të punës (vlerësuar nga AFP)

	Tremujori .2. 2014		Ndryshimi vjetor Tr.2.2014-Tr.2.2013		Ndryshimi tremujor Tr.2.2014-Tr.1.2014	
	Individë	%	Individë	%	Individë	%
Të punësuar 15 vjeç e lart	1.038.721	100	14.704	1,4	68.843	7,1
prej të cilëve						
15-64 vjeç	1.006.307	96,9	15.869	1,6	70.707	7,6
15-29 vjeç	191.845	18,5	-4.994	-2,5	4.323	2,3
30-64 vjeç	814.462	78,4	20.862	2,6	66.384	8,9
Të papunë 15 vjeç e lart	216.491	100,0	21.864	11,2	1.165	0,5
prej të cilëve						
15-64 vjeç	216.087	99,8	21.579	11,1	1.719	0,8
15-29 vjeç	96.505	44,6	20.236	26,5	15.406	19,0
30-64 vjeç	119.582	55,2	1.344	1,1	-13.687	-10,3
Inaktivë 15 vjeç e lart	1.085.560	100,0	-18.074	-1,6	-64.251	-5,6
prej të cilëve						
15-64 vjeç	770.343	71,0	-29.715	-3,7	-66.874	-8,0
15-29 vjeç	408.616	37,6	-30.794	-7,0	-49.789	-10,9
30-64 vjeç	361.727	33,3	1.079	0,3	-17.085	-4,5
Forca e punës 15 vjeç e lart	1.255.212	100,0	36.568	3,0	70.008	5,9
prej të cilëve						
15-64 vjeç	1.222.394	97,4	37.448	3,2	72.426	6,3
15-29 vjeç	288.351	23,0	15.242	5,6	19.729	7,3
30-64 vjeç	934.044	74,4	22.206	2,4	52.697	6,0

Fig. 1 Shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç, Tr.1/12 - Tr.2/14



Punësimi

Në tremujorin e dytë të vitit 2014, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është 61,3 %. Për femrat shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 50,1 % dhe për meshkujt 73,2 %. Krahasuar me tremujorin pararendës, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është rritur me 3,5 %. Ky tregues është rritur si për femrat ashtu dhe për meshkujt përkatësisht me 2,1 pikë përqindje dhe 5,3 pikë përqindje.


Gjatë tremujorit të dytë 2014, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 41,4 %. Shkalla e punësimit të të rinjve është 27,5 %.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 30-64 vjeç është 72,1 %. Shkalla e punësimit për këtë grupmoshë është 62,9 %.

Gjatë tremujorit të dytë 2014, 43,3 % e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë, dhe 22,2 % e të punësuarve punojnë në sektorin e shërbimeve të tregut (tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automobilave; hotelet dhe restorantet; transportet, magazinimi dhe komunikacioni; ndërmjetësimi monetar dhe financiar; pasuritë e patundshme).


Punësimi në sektorin e shërbimeve jo të tregut (administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi shoqëror i detyruar; arsimi; shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale; aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual; shërbime në shtëpi; aktivitete të organizmave ndërkombëtare) përbën 16,7 % të punësimit total. Të punësuarit në industrinë përpunuese përbëjnë 8,1 % të të punësuarve gjithsej.

Fig. 2 Struktura e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike, Tr.2/14



Gjatë tremujorit të dytë 2014, pesha që zënë në punësimin total të punësuarit me pagë është 41,3 %. Të vetëpunësuarit (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë me pagë) përbëjnë 24,8 % të të punësuarve në tërësi, ndërsa punëtorët pa pagesë të familjes përbëjnë 34 % të punësimit total.

Fig. 3 Shkalla e punësimit sipas statusit në punësim dhe nivelit arsimor, Tr.2/14



Shkalla e punësimit është më e lartë për të punësuarit me arsim të lartë (70,2%), pasuar nga ata me arsim të mesëm profesional (62,4%). Të dhënat tregojnë se përqindja e të punësuarve me pagë është më e lartë për personat me arsim të lartë, dhe e kundërta vërehet tek të punësuarit me arsim 8/9 vjeçar ku mbizotërojnë punëtorët pa pagesë të familjes.

Po të analizojmë të punësuarit me arsim të mesëm, shkalla e punësimit është më e lartë për personat me arsim të mesëm profesional krahasuar me personat që kanë kryer shkollën e mesme të përgjithshme, përkatësisht 62,4 dhe 44,2%.

Një në pesë të punësuar me arsim 8/9 vjeçar janë të punësuar me pagë, pak më shumë se gjysma janë punëtorë pa pagesë të familjes, dhe më pak se një e treta e tyre janë të punësuar me pagë. Pesha që zënë të punësuarit me pagë rritet me rritjen e nivelit arsimor. Nga të punësuarit me arsim të lartë 86,7% janë të punësuar me pagë dhe vetëm 4,2% janë të punësuar si punëtorë pa pagesë të familjes. Tek të punësuarit me arsim të mesëm profesional dhe me arsim të mesëm të përgjithshëm përqindjet që zënë të punësuarit me pagë janë pothuajse të njëjta.

Papunësia

Gjatë tremujorit të dytë 2014 në Shqipëri, numri i personave të moshës 15-64 vjeç që kërkojnë punë në mënyrë aktive është 216.087 persona. Shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç është 17,7 %. Për këtë grupmoshë, shkalla e papunësisë mbetet më e lartë për meshkujt sesa për femrat, përkatësisht 19,8 % dhe 14,7 %.

Krahasuar me tremujorin e parë 2014, vihet re se shkalla e papunësisë për meshkujt ka mbetur pothuajse e njëjtë, ndërsa për femrat ka një rënie prej 2,1 pikë përqindje.

Shkalla e papunësisë për personat me arsim të mesëm të përgjithshëm është 25,1 % ose 7,5 pikë përqindje më e lartë se niveli mesatar kombëtar. Personat me arsim të lartë kanë një shkallë papunësie prej 16,1 %. Për personat me arsim të mesëm profesional dhe ato me arsim deri në 8/9 vjeçar shkalla e papunësisë është 15 %.

Gjatë tremujorit të dytë 2014 për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë është 33,5 %. Krahasuar me tremujorin pararendës, shkalla e papunësisë për të rinjtë u rrit me 3,3 pikë përqindje.

Për popullsinë 30-64 vjeç në tremujorin e dytë 2014 shkalla e papunësisë është 12,8 %.

Përsa i përket mënyrave të kërkimit për punë, 85 % të papunëve u drejtohen të afërmeve apo miqve/shokëve për të gjetur një punë. Kjo metodë e kërkimit për punë është e kombinuar dhe me aplikimin direkt tek një punëdhënës (51,4 %) si dhe me vendosjen e lajmërimeve në gazeta, studimin e lajmërimeve për vende të lira pune në gazeta etj.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2014, personat që po kërkonin punë për herë të parë përbënin 59,2 % të punëkërkuesve të papunë.

Popullsia ekonomikisht jo-aktive

Gjatë tremujorit të dytë 2014 numri i personave të moshës 15-64 vjeç jashtë tregut të punës dhe që nuk po kërkojnë punë ose nuk janë të disponueshëm për të punuar (ndryshe popullsia ekonomikisht jo-aktive) është 770.343.

Popullsia e moshës 15-64 vjeç e klasifikuar si ekonomikisht jo-aktive përbën 38,7 % të popullsisë në moshë pune. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se janë nxënës/studentë ose në trajnim përbëjnë 65,6 % të të rinjve ekonomikisht jo aktivë.

Gjatë tremujorit të dytë 2014, 18,7 % e popullsisë ekonomikisht jo aktive e moshës 15-64 vjeç është duke përmbushur detyrat shtëpiake.

Gjatë tremujorit të dytë 2014, sipas vlerësimeve të ATFP, 16,1 % e popullsisë (15-64 vjeç) ekonomikisht jo-aktive janë të papunë të dekurajuar.

Ndër të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ekonomikisht jo aktivë, 12,6 % klasifikohen si të papunë të dekurajuar ndërsa në popullsinë më të rritur të moshës 30-64 vjeç ky grup përbën 20,1 % të popullsisë ekonomikisht jo aktive të kësaj grupmoshe.

Nga ATFP rezulton se 10,8 % e popullsisë ekonomikisht jo-aktive e moshës 15-64 vjeç janë në pension ndërsa pak më shumë se 7,7 % janë në paaftësi të përhershme.

Tab. 2 Shkalla e papunësisë Tr.1/12 - Tr.2/14

Mosha	Gjinia	Tr.1 2012	Tr.2 2012	Tr.3 2012	Tr.4 2012	Tr.1 2013	Tr.2 2013	Tr.3 2013	Tr.4 2013	Tr.1 2014	Tr.2 2014
15 vjeç e lart	Totali	12,9	13,3	13,6	13,6	14,3	16,0	16,8	16,8	18,2	17,2
	Meshkuj	14,2	15,0	14,6	14,7	15,4	18,0	19,3	18,6	19,4	19,3
	Femra	11,4	11,0	12,2	12,1	13,1	13,3	13,5	14,3	16,4	14,4
15-64 vjeç	Totali	13,4	13,7	14,1	14,1	14,8	16,4	17,2	17,1	18,6	17,7
	Meshkuj	14,6	15,5	15,2	15,4	16,0	18,6	19,8	18,9	19,9	19,8
	Femra	11,7	11,3	12,6	12,4	13,4	13,6	13,8	14,6	16,8	14,7
15-29 vjeç	Totali	23,6	24,6	29,6	26,6	25,4	27,9	27,3	28,3	30,2	33,5
	Meshkuj	24,8	27,7	31,8	29,6	26,4	32,1	31,4	28,9	33,0	37,1
	Femra	21,7	19,4	25,9	21,4	24,0	21,6	21,2	27,4	25,4	27,1
30-64 vjeç	Totali	10,1	10,2	9,3	10,4	11,7	13,0	14,2	13,5	15,1	12,8
	Meshkuj	10,9	11,1	9,3	10,4	12,7	14,2	16,1	15,5	15,5	13,8
	Femra	9,2	9,2	9,3	10,3	10,6	11,5	11,8	11,0	14,6	11,5

Tab. 3 Shkalla e punësimit Tr.1/12 - Tr.2/14

Mosha	Gjinia	Tr.1 2012	Tr.2 2012	Tr.3 2012	Tr.4 2012	Tr.1 2013	Tr.2 2013	Tr.3 2013	Tr.4 2013	Tr.1 2014	Tr.2 2014
15 vjeç e lart	Totali	51,1	50,2	48,6	48,7	47,0	44,1	42,9	42,4	41,5	44,4
	Meshkuj	56,7	56,2	55,3	55,4	53,0	50,7	49,2	49,8	48,3	52,2
	Femra	45,6	44,3	41,9	42,0	41,5	38,1	37,1	35,5	34,9	37,1
15-64 vjeç	Totali	58,2	56,8	54,2	54,4	52,8	49,9	48,6	48,2	47,1	50,5
	Meshkuj	63,9	62,9	61,0	61,1	59,5	57,2	55,8	56,7	54,4	58,7
	Femra	52,4	50,8	47,5	47,8	46,7	43,3	42,1	40,5	39,9	42,7
15-29 vjeç	Totali	38,0	36,7	31,5	32,0	30,1	27,6	27,3	27,8	25,8	27,5
	Meshkuj	42,9	40,8	35,7	35,9	35,6	32,3	32,0	34,8	30,2	32,8
	Femra	32,2	31,9	26,6	27,3	24,8	23,1	22,8	21,3	21,1	22,1
30-64 vjeç	Totali	67,9	66,5	65,6	65,8	65,1	62,4	60,2	59,6	59,4	62,9
	Meshkuj	75,6	74,9	75,4	75,6	73,0	71,7	69,1	69,3	69,4	73,5
	Femra	61,0	58,7	56,6	56,8	58,2	54,2	52,3	50,9	50,0	53,2

Tab. 4 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës Tr.1/12 - Tr.2/14

Mosha	Gjinia	Tr.1 2012	Tr.2 2012	Tr.3 2012	Tr.4 2012	Tr.1 2013	Tr.2 2013	Tr.3 2013	T.4 2013	Tr.1 2014	Tr.2 2014
15 vjeç e lart	Totali	58,7	57,9	56,2	56,4	54,9	52,5	51,5	50,9	50,8	53,6
	Meshkuj	66,1	66,1	64,8	65,0	62,6	61,9	60,9	61,2	59,9	64,7
	Femra	51,5	49,8	47,7	47,8	47,7	43,9	42,9	41,4	41,8	43,3
15-64 vjeç	Totali	67,1	65,8	63,1	63,4	62,0	59,7	58,6	58,1	57,9	61,3
	Meshkuj	74,9	74,5	72,0	72,2	70,9	70,3	69,6	70,0	68,0	73,2
	Femra	59,4	57,2	54,3	54,6	53,9	50,2	48,8	47,4	47,9	50,1
15-29 vjeç	Totali	49,8	48,6	44,8	43,6	40,3	38,3	37,5	38,8	36,9	41,4
	Meshkuj	57,0	56,4	52,3	51,0	48,5	47,6	46,6	49,0	45,1	52,2
	Femra	41,1	39,5	35,9	34,7	32,6	29,5	29,0	29,3	28,2	30,3
30-64 vjeç	Totali	75,6	74,1	72,3	73,4	73,8	71,7	70,2	68,9	69,9	72,1
	Meshkuj	84,8	84,3	83,2	84,4	83,6	83,5	82,4	82,0	82,1	85,3
	Femra	67,1	64,7	62,4	63,3	65,1	61,3	59,3	57,2	58,6	60,1

Informacion për përdoruesit

INSTAT, pas publikimit në maj 2014 të shifrave të plota të popullsisë për vitet 2001-2014 (<http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>) të cilat reflektonin ndryshimet e popullsisë që vinin nga Censusi i Popullsisë dhe i Banesave 2011, ka rishikuar serinë kohore të Anketës Tremujore të Forcave të Punës.

Baza e përgjithësimin të rezultateve të Anketës Tremujore të Forcave të Punës është popullsia dhe numri i njërive ekonomike familjare sipas 12 qarqeve dhe ndarjes urbane dhe rurale, të vlerësuara në vitin kur kryhet anketa. Për popullsinë përdoret ndarja sipas këtyre katër grupmoshave kryesore: 0-14 vjeç; 15-29 vjeç; 30-64 vjeç dhe 65 vjeç e lart.

Informacioni demografik ka pësuar ndryshime të ndjeshme në strukturën e popullsisë dhe të njërive ekonomike familjare dhe si rrjedhim ka ndikuar në ndryshimet e treguesve të tregut të punës për periudhën nga tremujori i parë i vitit 2012 deri në tremujorin e parë 2014.

Metodologjia

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve. Objektivi kryesor i saj është të japë informacion mbi situatën e tregut të punës në Shqipëri i cili përdoret për të hartuar politikat e tregut të punës dhe për vlerësimin e efektshmërisë së tyre, si dhe për të kënaqur nevojat e përdoruesve të statistikave për të dhëna të përditësuara mbi dinamikën e tregut të punës.

Në vitet 2007-2011 Anketa Tremujore e Forcave të Punës është kryer nga INSTAT me periodicitet vjetor. Në vitin 2012, Anketa Tremujore e Forcave të Punës u projektua si një anketë pilot për marrjen e vlerësimeve tremujore për punësimin dhe papunësinë në nivel kombëtar. Nga tremujori i parë 2013 e në vazhdim, INSTAT publikon tregues mbi tregun e punës të vlerësuar bazuar në të dhënat e Anketës së Forcave të Punës me periodicitet tremujor.

Për ATFP përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen ekzaktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së parë. Sipas strukturës panel të përdorur, në çdo tremujor një e pesta e familjeve të zgjedhura janë të reja dhe 80 përqind e familjeve janë të njëjta. Pra, në çdo tremujor në kampionin e zgjedhur për anketën shtohen 1.008 familje të reja dhe hiqet po i njëjti numër familjesh pasi është intervistuar në 5 tremujorë të njëpasnjëshëm.

Masa e kampionit të zgjedhur për anketim është 5.040 familje për çdo tremujor. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave gjeografike (të zgjedhura në hapin e parë) zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 8 familjesh.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Në familjet e zgjedhura u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart. Pyetëtori i ATFP është hartuar me asistencën teknike të EUROSTAT dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet dhe rregulloret e EUROSTAT. Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientët e variacionit të treguesve kryesorë, hartimin e pyetëtorit, si dhe me procedurat e peshimit të të dhënave.

Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. **Java e referencës** është java kalendarike nga e hëna në të dielë para datës së intervistës

Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës, si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkoshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trainim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar.

Të papunë konsiderohen personat që ishin:

- a) pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi.
- b) aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës).
- c) duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjensi private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj.
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta
- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, liçenca ose burime financiare

Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.

Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtepiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.